



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:089101

Datë: 22.10.2020

Numri i dokumentit: 01211779

C.nr.1701/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Mevlide Shabani kryetare e trupit, gjyqtarëve porotë Nuri Selmani dhe Miftar Maloku, anëtar të trupit, në çështjen juridike të propozuesve A. A., nga Gjilani, me vendqëndrim të përkohshëm në Gjermani, me adresë në Obere, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Vlora Berisha nga Gjilani dhe propozuesja F. A., e lindur Ibrahimimi, me vendbanim në fshatin Komuna e Novobërdës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Tefik Dushica nga Gjilani, me propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jo publik, më dt.22.10.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesve, A. A. nga Gjilani dhe F. A., e lindur Ibrahimimi nga fshati Komuna e Novobërdës, për zgjidhjen e martesës së lidhur para personit të autorizuar të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, me numër rendor dhe numer serik M e datës 14.07.2020 dhe numer të referncës, ndërmjet:

Propozuesit, A. A., i lindur me datë....., në Gjilan, nga babai R. A. dhe nëna M. A., me shtetësi Kosovar.

Propozueses F. A., e lindur Ibrahimimi, e lindur me datë, në Gjilan, nga babai N. I. dhe nëna M. I., me shtetësi Kosovar, në të cilën martesë nuk kanë fëmijë e as që pritet të kenë.

Sh k u r o r z o h e n në pajtim me dispozitën e nenit 68.2 dhe 69,2 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

II. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Propozuesit, në këtë gjykatë më dt.22.07.2020, kanë ushtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës të lidhur me dt. 04.10.2020, në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjilan, duke theksuar se në fillim marrëdhëniet bashkëshortore kishin qenë të mira, mirëpo në ndërkohë për shkak të botkuptimeve të ndryshme dhe mospajtimit të karaktereve , mardhënjet ndërmjet tyre janë çrregulluar. Disa herë kishin tentuar që ti harmonizojnë mardhëniet e tyre por përkundër tentimeve të njëpasnjëshme nuk kishin dhënë rezultate dhe si të tilla kishin dështuar. Pasi që nuk ishin gjasat për rivendosjen e bashkësis martesore, bashkshortët ishin mare vesh që martesën ta zgjedhin me propozim të përbashkët, ashtu që gjykatës i kanë propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjykata të aprovojë propozimin e propozuesve të lartcekur dhe të njejtit të shkurorëzohen në pajtim me Ligjin për Familjen i Kosovës.

E autorizuar e propozuesit av. Vlora Berisha, gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim te dt. 21.07.2020, duke theksuar se propozuesit asnjëherë nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët, andaj meqenëse në këtë martesë nuk kanë fëmijë i propozon gjykatës që martesën e tyre të lidhur me dt. 04.10.2019, të zgjidhin ashtu siq parashihet me dispozita ligjore . Ka shtuar se nëse gjykata e aprovon propozimin e tillë do të hjekin dorë nga e drejta në ankesë.

I autorizuari i propozueses av. Tefik Dushica, gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës, duke theksuar se edhe përkunder përpjekjeve të familjarëve që të vazhdoi edhe më tutje kjo martesë nuk ka patur rezultate. Gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tersi propozimi i përbashkët si të bazuar me ligj. Nëse gjykata e aprovon deklaron se hjeqin dorë nga e drejta në ankesë .

Gjykata për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare gjatë shqyrtimit kryesor, ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Çertifikatën e martesës me numër serik me nr. të referencës .. RM/4001 e dt.2020, e leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan.

Gjykata analizoi provën e propozuar, duke u bazuar në nenin 8 të LPK-ës dhe vërtetoi se: Martesa e propozuesve A. A. dhe F. A. e lindur I.,është lidhur në bazë të çertifikatës se martesës me numër serik me nr. të referencës RM..... e dt.2020, e leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan.

Me rastin e vendosjes në mënyrë meritore të çështjes civile, gjykata ka zbatuar dispozitat materiale të Ligjit Për Familjen i Kosovës, respektivisht nenin 68 dhe 69 të po këtij ligjit, të cilat dispozita janë në harmoni të plotë me dispozitat

Kushtetuese së Republikës së Kosovës, edhe ate neni 37, parag. 2, mbi barazinë e bashkeshortëve dhe rregullimin e martesës me ligj.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pas parasysh faktet e konfirmuara nga palët ndërgjyqëse, se martesa e tyre ka dështuar dhe se palët nuk jetojnë së bashku, andaj gjykata konsideron se me jetë të ndarë bashkëshortore nuk mund të arrihet qëllimi shoqëror i martesës, që është jeta e përbashkët, andaj konform nenit 68 dhe 69 të LFK, martesën e tyre e zgjidhi me shkurorëzim.

Gjykata konform nenit 450 të LPK-ës, vendosi që secila palë ti bart vet shpenzimet e procedurës.

Andaj duke u bazuar në këto prova materiale e konform nenit 143 të LPK-ës, lidhur me nenet 68,69, të LFK-ës, nenit 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që palëve iu është komunikuar aktgjykimi i shpallur, të autorizuarit e propozuesve kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në ankesë, andaj ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm në ditën e komunikimit të tij.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Më dt. 22.10.2020

Kryetarja trupit gjykues,
Mevlide Shabani d.v.

Ky aktgjykim është i plotfuqishëm më dt. 22.10.2020

Kryetarja trupit gjykues,
Mevlide Shabani d.v.